

Përmbledhje

SUBJEKT I MONITORUAR: VIOLA CANAJ, GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR VLORË



RAPORTIM PARAPRAK I SEANCËS DËGJIMORE DATË 21/11/2022 PRANË KPK:

Proçesi i rivlerësimit për subjektin është realizuar bazuar në të tre kriteret: kriteri i pasurisë, kriteri i kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Nga institucionet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI; KLP dhe DSIK, janë paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit.

KPK bazuar në hetimin administrativ të tij, relatoi një sërë problematikash me karakter pasuror.

Gjatë seancës dëgjimore, u evidentua se publiku ka sjellë në vëmendje të KPK-së 5 denoncime.

KPK vendosi konfirmimin në detyrë në gjyqtares znj. Viola Canaj



Vëzhguesit e KShH-së monitorojnë të drejtën për proces të rregullt në procesin e vettingut ndaj gjyqtares Znj. Viola Canaj, e cila u konfirmua në detyrë nga KPK

Më datë 21 nëntor 2022 ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit znj. Viola Canaj, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Trupa gjykuese përbëhej nga z. Roland Ilia (Kryesuese), znj. Brunilda Bekteshi (Relatore) dhe znj. Pamela Qirko (Anëtar), si dhe u asistua nga vëzhguesia ndërkombëtare znj. Marie Tuma në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

KPK informoi se hetimi administrativ mbi subjektin e rivlerësimit është përfunduar për të tre kriteret, atë të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Trupa gjykuese relatoi përmbledhtas relacionet e hartuara, në përfundimit të hetimit administrativ të vetë KPK-së.

Gjatë seancës dëgjimore, u vërejt mungesa e subjektit të rivlerësimit për arsye shëndetësore, megjithatë ajo u përfaqësua ligjërisht nga bashkëshorti i saj, që ushtron funksionin e avokatit. Mbrojtësi ligjor nuk paraqiti kërkesa paraprake apo proceduriale në lidhje me hetimin ose trupën gjykuese.

Nga organet ndihmëse të procesit të rivlerësimit si ILDKPKI, KLGJ dhe DSIK, ishin paraqitur dhe administruar raporte pozitive për subjektin e rivlerësimit. Nga relacioni i hartuar nga KPK, bazuar në hetimin administrative të tij, u relatuan një sërë problematikash me karakter pasuror, si ndryshimi i vlerës së shitjes për të pasurisë së paluajtshme (apartament); bilanc negativ në analizën financiare për vitet 2007, 2008 dhe 2013; dyshimet mbi pamundësinë financiare të prindërve të bashkëshortit të subjektit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për shlyerjen e këstit të parë dhe të tretë të kredisë së marrë në vitin 2007. Në seancë, përfaqësuesi ligjor nuk parashtroi fakte të reja përtej atyre për të cilat më herët ishin depozituar spjegime.

Gjatë seancës dëgjimore, u evidentua se publiku ka sjellë në vëmendje të KPK-së 5 denoncime. Gjatë analizimit dhe hetimit nga KPK ka rezultuar se në 3 raste nuk ka qenë e mundur të identifikohen rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit, ndërkohë për 2 rastet e tjera janë kërkuar spjegime nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Në rastin e parë, Komisioni i ka kërkuar spjegime subjektit lidhur me pretendimin e denoncueses për marrjen e një vendimi të padrejtë, mbi procesin gjyqësor me objekt “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” nga i cili ka mbetur i dëmtuar një fëmijë. Gjithashtu pretendim për vendim të padrejtë është ngritur dhe nga ankuesi i dytë mbi një proces gjyqësor penal ndaj një shtetasi të gjykuar për veprat penale të “Vrasjes me paramendim”, “Armëmbajtje pa leje”, “Prodhim i armëve shpërthyes dhe municione”.

Trupa gjykuese dhe vëzhguesi ndërkombëtar nuk depozituan pyetje shtesë kundrejt subjektit të rivlerësimit.

Në seancën për shpalljen e vendimit përcaktuar në datë 23.11.2022, KPK vendosi konfirmimin në detyrë të gjyqtares znj. Viola Canaj.